



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 231, datë 02.07.2020

PËR
MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË GJYQTARES {...} PËR PËRJASHTIMIN E SAJ
NGA LISTA E GJYQTARËVE QË CAKTOHEN PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE
GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO
KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në paragrafin VIII, pika 6 e vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, si dhe në bazë të kërkesës datë 10.06.2020 të gjyqtares {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e kërkesës së gjyqtares {...} për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR